



PRISHTINA



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË  
GJF "AUTOBUSKA STANICA" A. D. PRISHTINA  
MPE "BUS STATION" J.S. PRISHTINA

## FTESË PËR ANKAND PUBLIK (Dhënia e hapësirave/lokaleve me qira)

### 1. Dhënia e hapësirave afariste me qira

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë njofton të gjithë të interesuarit se ofron hapësirat/lokalet për qiradhënie përmes procedurës së ankandit publik, si në vijim:

Nr.	Njësia	Sipërfaqja/m <sup>2</sup>	Nr. i lokalit/hapësirës	Çmimi fillestar/€
1.	Autolarje	• 534.13 Lokal • 1,066.87 Oborr/terase	25	1,500.00
2.	Hapësire per parking	539.00	33	430.00
3.	Zyre	382.94	22	800.00
4.	Sportel	3.00	3	200.00
6.	Lokal	8.32	18	174.72

Shënim: Të gjitha çmimet janë pa TVSH.

Kriteri i dhënies së kontratës është çmimi më i lartë i ofruar. Në rast që ekziston vetëm një oferte lidhur me njësinë afariste të caktuar, Bordi i Drejtoreve të ndërmarrjes ka të drejtë të beje negociata me palën e interesuar lidhur me çmimin final të njësisë afariste të caktuar.

Preferencat e dëshirueshme për lëshimin hapësirave me qira gjatë procesit të ankandit:

- Për njësinë "Autolarje" numri i lokalit 25, preferohet ndonjë veprimtari për autolarje, parking të veturave, auto-taksive apo ndonjë kompani autotransportuese për shfrytëzim për nevojat e veta parkimi dhe larje të autobusëve, të cilat veprimtari nuk bien ndesh me veprimtarin e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë;
- Hapësira për parking në numrin rendor 2, numri i hapësirës 33 gjendet përballe hapësirës afariste "Autolarja" dhe mund të përdoret për parking të veturave, autobusëve apo mjeteve tjera, të cilat veprimtari nuk bien ndesh me veprimtarin e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë;
- Për lokalin nr.18 dhe për hapësirën afariste "Zyre" preferohet zyre, apo veprimtari të ngjashme, për kompani autotransportuese, apo ndonjë veprimtari tjetër e lejuar dhe e cila nuk bie ndesh me veprimtarinë e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë ;
- Për sportelin nr.3 preferohet zyre, apo veprimtari e ngjashme për kompanitë autotransportuese.

Të drejtë pjesëmarrje kanë personat juridik. Si dëshmi ofrojnë certifikatën e regjistrimit të biznesit. Afati i dhënies me qira është një (1) vjeçar me mundësi vazhdimi, bazuar në rregulloren e brendshme lidhur me lëshimin e hapësirave me qira dhe vendosjen e objekteve.

## 2. Kushtet dhe obligimet tjera

- Nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand janë të përjashtuar të gjithë debitorët që kanë obligime të pa shlyera ndaj ndërmarrjes NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë.
- Te gjitha palët e interesuara mund t'i shikojnë hapësirat/lokalet çdo ditë pune nga ora 08:00 deri me 16:00.
- Afati për dorëzimin e ofertave është deri me 04.02.2022, ora 14:00, hapja e ofertave bëhet në orën 14:30.
- Ofertat dorëzohen në zarfe të mbyllura dhe dorëzohen në zyrën e arkivit të ndërmarrjes.
- Të drejtë pjesëmarrje në hapjen e ofertave kanë të gjithë ofertuesit.
- Palët fituese ne afatin prej 5 ditësh pas mbylljes se procedurës së ankandit duhet ti nënshkruajnë kontratat mbi qiranë, dhe te bëjnë pagesën e faturës se pare.
- Informatat me të hollësishme mund të merren përmes emali-t: [contact@sap-ks.com](mailto:contact@sap-ks.com) apo ne numër te telefonit 038 551 333.